



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1540, datë 04.04.2011

Për

**“Shqyrtimin e Ankimit Administrative të Eagle Mobile sh.a për Vendimin Nr.1508,
datë 10.02.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 04.04.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Shqyrtimin e Ankimit Administrativ të Eagle Mobile sh.a për Vendimin Nr.1508,
datë 10.02.2011 të KD të AKEP”.**

Dokumentacioni i Grupit të Punës të ngritur me Urdhërin e Brendshëm nr. 639, datë 15.11.2010, përbëhet nga:

- Projekt vendimi;
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit;

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 53, 55, 56, 57, 58 dhe 59, i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.
3. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1212, datë 31.03.2010, i ndryshuar.
4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.1505, datë 10.02.2011, “Miratimin e Dokumentacionit Final: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”
5. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.1506, datë 10.02.2011, Për “Miratimin e metodologjive të rregullimit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a”.
6. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.1507, datë 10.02.2011, Për “Miratimin e metodologjive të rregullimit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a”
7. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.1508, datë 10.02.2011, Për “Miratimin e metodologjisë së rregullimit për orientimin në kosto të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a”

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankimi Administrativ i Eagle Mobile sh.a. derguar me shkresën Nr.Prot. 903, datë 10.03.2011.
2. Projektvendim i KD të AKEP për “**Shqyrtimin e Ankimit Administrativ të Eagle Mobile sh.a për Vendimin Nr. 1508, datë 10.02.2011, të KD të AKEP**”
3. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*), si dhe,
4. Nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N:

1. Eagle Mobile sh.a., nëpërmjet shkresës Nr. Prot 903, datë 10.03.2011, ka bërë ankim administrativ për Vendimin Nr.1508, datë 10.02.2011 të KD të AKEP duke kërkuar:
 1. Ndryshime në vlerat maksimale të tarifës së terminimit në rrjetin e EM, të dhëna në Tabelën 1, Aneksi 1, në favor të ruajtjes së balancës së të ardhurave nga interkoneksioni si dhe sugjerimeve të dokumentave rregullatorë të BE, duke ruajtur asimetrimin në nivelin 30-35 %, me operatorët VFAL/AMC;
 2. Ndryshime në afatet kohore të përshkallëzimit të MTR, duke zgjatur afatin kohor të asimetrisë midis EM dhe VFAL/AMC nga 4 në 6 vjet, në përputhje me kushtet aktuale të tregut të komunikimeve elektronike.

2. EM ka bërë kërkesën e mësipërme duke argumentuar:
 1. Eagle Mobile sh.a., e ka kundërshtuar modelin BU-LRAIC, pasi rezultatet e tij bazohen në analizën e prototipit në tregun shqiptar të komunikimeve elektronike të vitit 2008, ndërkohë që Eagle Mobile sh.a., ka hyrë në treg më 13 Mars 2008.
 2. Eagle Mobile sh.a., insiston në domosdoshmërinë e marrjes në konsideratë të tarifave të terminimit për telefoninë e lëvizshme referuar “Benchmark” dhe mesatares së tarifës së terminimit në vendet europiane dhe jo Europiane, duke e aplikuar këtë në kushtet specifike të tregut shqiptar të komunikimeve elektronike.
 3. Eagle Mobile sh.a., kundërshton modelin e përdorur, afatin e shkurtër kohor të aplikimit të asimetrisë dhe vlerën e reduktuar të tarifave të terminimit (MTR) të Eagle Mobile sh.a., duke argumentuar se:
 - a. Për të vlerësuar asimetrimin në tarifatat e terminimit, autoriteti rregullator duhet të analizojë dhe të marrë parasysh kritere të ndryshme si: datën e hyrjes në treg të sipërmarrësit, trafikun e pabalancuar, ndarjen e të ardhurave, diferencën në kosto për sipërmarrësit që hyjnë me vonesë në nivelin e lartë të penetrimit etj;
 - b. Ruajtja e balancës mesatare të interkoneksionit midis EM dhe VFAL/AMC në kushtet aktuale, kur kemi të bëjmë me një hyrës të ri dhe dy operatorë të konsoliduar mund të rregullohet vetëm nëpërmjet aplikimit për një kohë më të gjatë të asimetrisë dhe ruajtjes së vlerës së saj në nivelin 30-35 %;
 - c. Për më tepër, masat e marra ndaj Eagle Mobile sh.a., janë të ndryshme në krahasim me trajtimin që i bëhet operatorit Plus Communication sh.a. AKEP, ka pranuar kërkesën e Plus Communication sh.a., për të pasur asimetri me operatorët e tjerë për një periudhë 5 vjeçare duke dhënë si shembull kohëzgjatjen e asimetrisë për Eagle Mobile sh.a. Pavarësisht se AKEP aplikon të njëjtin standard për kohëzgjatjen e asimetrisë për të dy operatorët e rinj në treg, standardi që është aplikuar për përqindjen e asimetrisë midis Eagle Mobile sh.a., dhe VFAL/AMC në momentin e

hyrjes në treg të EM është e ndryshme nga asimetria midis Plus dhe VFAL/AMC.

3. AKEP, pasi ka ka shqyrtuar kërkesat dhe argumentat e mësipërme konsideron se:
 1. Në lidhje me komentet në pikat 1 dhe 2 të EM, për përdorimin e modelit BULRAIC dhe metodës Benchmark për tarifën e terminimit, AKEP ka dhënë tashmë në dokumentin “Qëndrimi i AKEP për Komentet në Konsultimin Publik 10.02.2011”, të publikuar në përfundim të konsultimit publik në Janar 2011, dhe marrjes së Vendimeve të KD nr. 1505-1508, datë 10.02.2011. Dokumenti është publikuar në seksionin Konsultime të Përfunduara në faqen e Internetit të AKEP, www.akep.al. Gjithashtu, kjo çështje është trajtuar edhe në dokumentacionin final të modelit BULRAIC (përgjigjet e konsulentit për konsultimin publik në Korrik 2010), të publikuar në faqen e Internetit në seksionin Konsultime të Përfunduara.
 2. Për sa i përket kërkesës së EM për asimetri më të lartë dhe kohëzgjatje me të madhe të asimetrisë me Vodafone/AMC, AKEP ka marrë në konsideratë komentet e EM në konsultimin e kryer në Janar 2011 si dhe kushtet e tregut. Rritja e tarifës së terminimit në rrjetin EM në fazën e dytë (Shtator 2011-Gusht 2012), në Vendimin Nr. 1508, datë 10.02.2011 në krahasim me propozimin në konsultim publik, si dhe tarifa më e lartë për fazën e parë dhe të dytë në krahasim me propozimin e konsulentit ICC, janë vendosur nga AKEP duke u bazuar në komentet e EM, si dhe kushtet e tregut.
4. Argumentat e Eagle Mobile sh.a., konsiderohen të pamjaftueshme për të bërë ndryshime në nivelin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetin EM dhe të nivelit dhe kohëzgjatjes së asimetrisë së tarifave të EM në raport me tarifën e Vodafone/AMC, si dhe përfundimeve të tjera të përcaktuar në dokumentin “Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT-Dokumenti Final”, i miratuar me VKD nr. 1505, datë 10.02.2011, si dhe në vendimin nr. 1508 dhe/ose vendimet nr. 1506, nr. 1507 datë 10.02.2011.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij vendimi për konkurrencën në treg, sipërmarrësin dhe realizimin e objektivave rregullatore, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1, të nenit 115, të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21, të Rregullores së Brendshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të rrëzojë kërkesën ankimore të Eagle Mobile sh.a, të depozituar me shkresën Nr. Prot 903, datë 10.03.2011, për *Vendimin Nr.1508, datë 10.02.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP.*
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**